



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë - Akademija Pravde - Academy of Justice

Buletini informativ

- * Aktivitetet e përgjithshme
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- * Aktivitetet nga trajnimet për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor të gjykatave dhe prokurorive

Korrik-Gusht 2023

Aktivitetet e përgjithshme

Nënshkrimi i Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Akademisë së Drejtësisë dhe Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar



Më 12 korrik 2023 në Akademi të Drejtësisë është realizuar takimi i përbashkët mes përfaqësuesve të dy institucioneve z. Enver Fejzullahu-Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë dhe z. Enver Krasniqi – zv. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar.

Qëllimi i këtij takimi ishte fuqizimi edhe më tej i bashkëpunimit ndërinstitucional në çështjet me interes të përbashkët dhe konkretizimi i saj përmes nënshkrimit të Marrëveshjes së

Bashkëpunimit mes institucioneve përkatëse.

Gjatë takimit u diskutua për bashkërendimin e aktiviteteve në përmbushje të veprimtarisë sipas Ligjit për Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar dhe Ligjit për Akademinë e Drejtësisë.

Në fund të takimit z. Fejzullahu dhe z. Krasniqi nënshkruan Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet të dy institucioneve përmes të cilës do të shkëmbehen informatat dhe do të realizohen aktivitete të përbashkëta në fushën e sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive të krijuara në mënyrë të kundërligjshme dhe administrimin e tyre sipas ligjeve. Përmes kësaj marrëveshje zyrtarët e Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar do të përfitojnë nga Programet trajnuese të AD-së dhe veçanërisht në trajnimet e përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë në



Takimi me Donatorët e Akademisë së Drejtësisë



Më 19 korrik 2023 në kuadër të Akademisë së Drejtësisë është realizuar takimi i përbashkët me donatorët.

Qëllimi i këtij takimi ishte njohja me arritjet dhe sfidat e Akademisë së Drejtësisë në periudhën janar-korrik 2023 me theks të veçantë në trajnimet e vazhdueshme, program ky që në një pjesë të konsiderueshme gëzon mbështetjen nga donatorët si dhe nevojat për mbështetje edhe për gjysmën dytë të këtij viti duke përfshirë edhe për vitin 2024.

Me rastin e këtij takimi si fillim nga Drejtori i Akademisë u shpreh mirënjohja dhe falënderimi për mbështetjen e vazhdueshme të Akademisë nga donatorët dhe projektet dhe në vijim

prezantoi zhvillimet sa i përket programeve trajnuese dhe aktiviteteve të realizuara në periudhën janar - korrik 2023. Vëmendje e veçantë i është kushtuar mungesës së buxhetit të AD-së në raport me kërkesat dhe nevojat për trajnime.

Në vazhdim të takimit u diskutua për trajnimet e planifikuara për pjesën e dytë të vitit 2023 konkretisht për periudhën shtator-dhjetor 2023 dhe kordinimi me donatorët për mbështetjen e këtyre aktiviteteve.

Të gjithë partnerët e AD-së të pranishëm në këtë takim rikonfirmuan mbështetjen e Akademisë me ekspertizë, në trajnime për ngritje të shkathhtësive trajnuese, në fushën e të drejtave të njeriut dhe në trajnime tjera që janë rezultat i kërkesave dhe nevojave të Akademisë së Drejtësisë.

Në fund të takimit përfaqesuesit e donatorëve të Akademise u zotuan për mbështetjen e Akademise edhe në të ardhmen për realizimin e aktiviteteve në permbushje të mandatit të saj ligjor.



Punëtorja për rregulloret e brendshme të Akademisë së Drejtësisë



Më 24 dhe 25 korrik 2023, në bashkëpunim me EUKOJUST është realizuar Punëtorja për shqyrtimin e akteve nënligjore të AD-së të hartuara si rezultat i kërkesave ligjore të ndryshim dhe plotësimit të ligjit nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë.

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte shqyrtimi dhe finalizimi i akteve nënligjore me theks te Rregullorës për Trajnuesit dhe Mentorët,

plotësim-ndryshimin e Rregulloreve për Këshillin Drejtues dhe Këshillin Programor si dhe Rregullorës për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Akademinë e Drejtësisë në pajtim me Ligjin nr. 08L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura, përkatësisht kapitulli IV Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë.

Pjesëmarrës të kësaj punëtorie ishin Anëtarët e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, ekspertë nga EUKOJUST, ekspert nga OPDAT, zyrtar nga Ministria e Punëve të Brendshme, zyrtar nga Ministria e Financave, si dhe stafi udhëheqës i Akademisë së Drejtësisë.



Punëtorja për Vlerësimin e Nevojave për Trajnime për vitin 2024



Më 27 korrik 2023, në mbështetje të OPDAT përkatësisht Ambasadës Amerikane është realizuar Punëtorina për Vlerësimin e Nevojave për Trajnime për vitin 2024.

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte Vlerësimi i nevojave trajnuese për gjyqtarë dhe prokurorë dhe stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial duke përfshirë edhe prioritetet sipas dokumenteve strategjike të cilat obligojnë Akademinë e Drejtësisë në përmbushjen e tyre.

Me rastin e kësaj punëtorie janë shqyrtuar resurset që nevojiten për të adresuar të gjitha kërkesat për trajnime si dhe koordinimi ndërinstucional me KGJK dhe KPK si me rastin e përcaktimit të kurrikulës trajnuese ashtu

edhe në zbatimin e trajnimeve. Vëmendje e veçantë i është kushtuar nevojës për trajnime të stafit administrativ për shkak të rekrutimit të zyrtarëve të rinjë dhe nevojës për të orientuar programin trajnues në këto kategori.

Të pranishëm në këtë punëtori ishin akterët kryesorë të sistemit gjyqësor dhe prokurorial duke filluar nga Kryesuesi i KGJK-së z. Albert Zogaj, Kryetari i Gjykatës Supreme z. Fejzullah Rexhepi, zëvendës kryesuesi i KGJK z. Qerim Ademaj, përfaqësues nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, prokurorë nga Prokuroria Speciale, Kryetari i Gjykatës së Apelit z. Valon Totaj, Kryetarë të Gjykatave Themelore dhe Kryeprokuror të Prokurorive Themelore, si dhe stafi i Akademisë së Drejtësisë.

Kjo punëtori është moderuar nga Drejtori ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë z. Enver Fejzullahu dhe z. John P. Moran, ndihmës shef në Zyrën për Arsimim në Departamentin e Drejtësisë të Shteteve të Bashkuara (DOJ), Zyra e Edukimit Juridik (OLE), të mbështetur edhe nga specialistja ligjore nga Ambasada Amerikane znj. Benina Kusari.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar

Trajnimi fillestar për prokurorët e sapo emëruar, (gjenerata e X)- 2023-2024



Për 21 prokurorët e kësaj gjenerate gjatë muajit korrik janë realizuar gjithsej 18 sesione të trajnimit teorik dhe 12 ditë të trajnimit praktik.

Sesionet e trajnimit teorik ishin nga moduli: Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar si dhe Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese.

Nga moduli Kodi Penal i Republikës së Kosovës janë realizuar 8 sesione trajnuese. Nga nën moduli: Kodi Penal-pjesa e veçantë nga i cili janë trajtuar veprat penale të caktuara sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, veprat penale kundër pasurisë, veprat penale në kuadër të kapitullit XXVI të KPRK, veprat penale të kapitullit 401 të KPRK-së, ndotja degradimi ose shkatërrimi i mjedisit, veprat penale kundër sigurisë së përgjithshëm të njerëzve dhe pasurisë dhe veprat penale kundër sigurisë së trafikut urban dhe administratës publike. Në vijim të këtij moduli është realizuar edhe 1 sesion trajnues për Krimin Kibernetik me theks te teknologjia dhe ndikimi i zhvillimit të krimit kibernetik.

Nga moduli: “Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar” janë realizuar 9 sesione trajnuese për “KEDNJ me theks te Neni 2 i KEDNJ, garancitë procedurale për të drejtat e njeriut, neni 5 par. 1 i KEDNJ prezumimi në favor të lirisë, Gjykata Evropiane për drejtat e

njeriut, neni 6 i KEDNJ, neni 10 liria e shprehjes së gazetarëve dhe sinjalizuesve.

Në kuadër të modulit: “Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese është realizuar 1 sesion nga nën moduli: “Ligji për kundërvajtje”, nga i cili janë trajtuar veprat e kundërvajtjes dhe aktgjykimi për kundërvajtje.

Për muajin gusht, janë realizuar gjithsej 4 sesione të trajnimit teorik dhe 2 ditë të trajnimit praktik.

Sesionet e trajnimit teorik ishin vazhdimi i nën moduleve nga moduli: Kodi Penal i Republikës së Kosovës dhe nga : Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese.

Në kuadër të modulit: Kodi Penal i Republikës së Kosovës janë realizuar 2 sesione trajnuese nga nën moduli: “Krimi kibernetik” dhe kësaj radhe me fokus te Pajisjet dixhitale dhe provat elektronike .

1 sesion trajnues ishte nga nën moduli “Përgjegjësia e personave juridik” ku u diskutua lidhur me: Përgjegjësin penale të personave.

Ndërkaq nga modulit Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese është realizuar 1 sesion trajnues nga nën moduli: “Ligji për kundërvajtje” me ç 'rast janë trajtuar: Organet për paraqitje të kërkesës për zhvillimin e procedurës së kundërvajtjes, Aktgjykimet-aktvendimet dhe Mjetet Juridike

Gjatë sesioneve të trajnimit teorik prokurorët patën mundësinë e studimit të rasteve nga praktika gjyqësore të cilat njëherësh janë diskutuar, analizuar për të identifikuar praktikat më të mira në situatat përkatëse.

Trajnimi fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar, (gjenerata e X)-2023 -2024



Gjatë muajit korrik për 29 gjyqtarët e sapo emëruar (një prej tyre nga komuniteti boshnjak) janë realizuar gjithsej 42 sesione të trajnimit teorik nga nën modulet e modulit: E drejta civile, ekonomike dhe administrative, Shkathtësitë personale dhe ndërpersonale, Rendi Juridik Kombëtar dhe Ndërkombëtar si dhe moduli Kodi Penal i Republikës së Kosovës.

Nga moduli: E drejta civile, administrative dhe ekonomike janë realizuar 5 sesione trajnuese nga nënmoduli për të drejtën e punës. Në kuadër të këtyre sesioneve janë trajtuar aspekte të rëndësishme të kompensimit të dëmit të shkaktuar në punë, kontestet nga marrëdhënia e punës, sipas Ligjit për zyrtarët publik, sipas Ligjit të punës, mbrojtja në punë dhe për themelimin e marrëdhënies së punës.

Në vijim të këtij moduli janë realizuar edhe dy sesione nga nënmoduli për të drejtën ekonomike me theks te Falimentimi dhe zgjidhja alternative e kontesteve.

Pjesë e modulit nga e drejta civile, administrative dhe ekonomike është edhe nën moduli për të drejtën trashëgimore me çrast gjatë kësaj periudhe janë realizuar 4 sesione trajnuese me fokus te Kalimi i pasurisë trashëgimore të trashëgimtarët, pjesa e domosdoshme, cenimi i pjesës së domosdoshme, padenjësia dhe përjashtimi nga trashëgimia, trashëgimia në bazë të ligjit, dhe

radhët trashëgimor, trashëgimia në bazë të testamentit.

Në kuadër të modulit: Shkathtësitë personale dhe ndërpersonale janë realizuar 4 sesione trajnuese për arsyetimin e vendimeve në lëmine civile me theks te Interpretimi dhe arsyetimi ligjor, përdorimi i titujve dhe pikat referuese, shkrimi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore në fushën civile përmes metodës IRAC, struktura dhe përmbajta e arsyetimit të aktgjyqimit.

Nga moduli: Rendi Juridik Kombëtar dhe Ndërkombëtar janë realizuar 9 sesione trajnimi nga nën moduli “KEDNJ” nga i cili janë shtjelluar: Neni 2 i KEDNJ, garancitë procedurale për të drejtat e njeriut, neni 5 par. 1 i KEDNJ prezumimi në favor të lirisë, Gjykata Evropiane për drejtat e njeriut, neni 6 i KEDNJ, neni 10 liria e shprehjes së gazetarëve dhe sinjalizuesve.

Në vijim të këtij moduli është realizuar edhe 1 sesion trajnues nga nën modulit “Bashkëpunimi juridik ndërkombëtarë” me fokus në lëminë civile.

Po ashtu gjyqtarët gjatë këtij muaji kanë filluar edhe trajnimet nga lëmia penale kryesisht në modulën:: Kodi Penal i Republikës së Kosovës, ku në kuadër të nën modulit: Kodi penal - pjesa e përgjithshme janë realizuar 2 sesione me temat: Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale, dhe shtytja si dhe 1 sesion nga Kodi penal - pjesa e veçantë nga i cili u trajtuan veprat penale kundër ekonomisë.

Gjatë sesioneve të trajnimit teorik gjyqtarët patën mundësinë e studimit të rasteve nga praktika gjyqësore të cilat njëherësh janë diskutuar, analizuar për të identifikuar praktikat më të mira në situatat përkatëse.

Gjatë muajit gusht për 29 gjyqtarët e sapo emëruar (një prej tyre nga komuniteti boshnjak) janë realizuar gjithsej 8 sesione të trajnimit teorik nga nën modulet e modulit: moduli Kodi Penal i Republikës së Kosovës.

Prej tyre 4 sesione trajnuese ishin nga Kodi Penal-pjesa e përgjithshme” nga ku janë trajtuar: dashja, marrëveshja për të kryer veprë penale, mbrojtja e nevojshme, vepra penale dhe përgjegjësia penale.

Në vijim të këtij moduli nga pjesa e veçantë janë realizuar 3 sesione trajnuese me fokus te Veprat penale kundër pasurisë, veprat penale në kuadër të kapitullit XXVI- të Kodit Penal të Republikës

së Kosovës, veprat penale në kuadër të kapitullit XXVI- ë Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjithashtu nga nën moduli: “Krimi kibernetik” është realizuar 1 sesion trajnues me ç’rast është shtjelluar Shoqëria e Informacionit dhe krimi Kibernetik.

Gjatë sesioneve të trajnimit teorik gjyqtarët patën mundësinë e studimit të rasteve nga praktika gjyqësore të cilat njëherësh janë diskutuar, analizuar për të identifikuar praktikat më të mira në situatat përkatëse.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Program i Specializuar i Trajnimit Veprat penale të kryera nëpërmjet prokurimit publik – Sesioni I

Më 04-05 Korrik 2023, në bashkëpunim me US-DOJ/OPDAT, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme është realizuar “Programi i Specializuar i Trajnimit -Veprat penale të kryera nëpërmjet prokurimit publik – Sesioni I”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i shkathtësive të gjyqtarëve dhe prokurorëve në identifikimi e indikatorëve serioz të mashtrimit gjatë fazave të prokurimit publik dhe mënyrat dhe skemat e korrupsionit në fushën e prokurimit publik për zgjidhjen meritorë të rasteve në praktikën gjyqësore.

Në ditën e parë trajnimi u përqendrua në shpjegimet e hollësishme sa i përket procedurave të prokurimit publik, rolit dhe përgjegjësisë së institucioneve publike të përfshira në prokurimin publik, procesit të planifikimit të prokurimit publik dhe ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave. Në secilin prej këtyre fazave siq u tha mund të ekspozohet rreziku i skemave mashtruese dhe korruptive. Këto u elaboruan me raste studimore për të cilat vijuesit e këtij trajnimi patën rastin e diskutimit dhe identifikimit të shkeljeve apo

rreziqeve të skemave mashtruese.

Edhe në ditën e dytë është vazhduar me trajtimin e indikatorëve të mashtrimit në prokurim, zbulimin e mashtrimit dhe luftimin e korrupsionit dhe atë përmes rasteve praktike. Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe menaxhimit të kontratës dhe mashtrimit dhe korrupsionit në fazën pas dhënies së kontratës. Në fazën pas dhënies së kontratës siq u potencua rreziqet e mashtrimit lidhen me zbatimin e manipuluar të kontratës. Në dështim të përmbushjes së kushteve të kontratës, operatori ekonomik mund të furnizojë produkte inferiore e shpesh herë më të lira se ato që parashihen me kontratë dhe në këtë mënyrë operatorët ekonomikë mund të devijojnë nga detyrimet e tyre kontraktuale.

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: 2 gjyqtar dhe 10 prokuror të nivelit themelor si dhe 11 zyrtar policor.



Trajnim: Risitë e Kodit të Procedurës Penale



Me 7-8 korrik si dhe 14-15 korrik 2023, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me US-DOJ/OPDAT - OSBE, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar trajnimin me temë “Risitë e Kodit të Procedurës Penale” për regjionin e Gjakovës dhe regjionin e Prishtinës.

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte që pjesëmarrësit të njoftohen me Risitë esenciale të Kodit të Procedurës Penale të cilat kanë tendencë për ndryshime të nevojshme dhe efektive.

Trajnimi u orientua në ndryshimet sa i përket hedhjes së kallëzimit penal që reflekton në mundësinë e ankesës ndaj hedhjes së kallëzimeve penale nga Prokurori Shtetit, pasi që më parë nuk lejohej ankesë ndaj hedhjes së kallëzimit qoftë nga ana e parashtruesit apo të dëmtuarit nga vepra penale. Në vijim të risive ligjore u fol edhe për Mbrojtësin e detyruar, mbrojtësin me shpenzime publike dhe kur mbrojtja nuk është e detyruar dhe të drejtat e të dëmtuarit ose viktimës, të drejtën për të apeluar aktvendimin, masat e veçanta hetimore, mbrojtja e dëshmitarëve, marrja në pyetje në procedurë paraprake, deklarata në procedurë paraprake, mundësia hetuese e veçantë, hetimi (afati i hetimeve, pushimi dhe rihapja e

hetimeve). Trajtimi i këtyre çështjeve është bërë duke prezantuar sfidat e identifikuara në praktikën e gjykatave dhe prokurorive.

Në këtë trajnim u trajtua edhe Marrëveshja për pranimin e fajësisë dhe dëshmitarët bashkëpunues, qasja publike në aktakuzë dhe publikimi i aktgjykimit. Ndër të tjera u shtjellua edhe Shqyrtimi i dytë, aktakuza e konfirmuar dhe caktimi i shqyrtimit gjyqësor duke u vazhduar me standardin e rishikimit të ankesave shkeljet substanciale, ndryshimi i aktgjykimit nga Gjykata e Apelit, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, sekuestrimi dhe konfiskimi si dhe procedura penale ku përfshihen kryesit me çrregullime mendore.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar me raste praktike.

Pjesëmarrës të këtij trajnimi nga regjioni i Gjakovës ishin 29 pjesëmarrës. Prej tyre 8 gjyqtarë, 3 prokurorë si dhe 18 bashkëpunëtorë të gjykatave dhe prokurorive.

Pjesëmarrës të trajnimit nga regjioni i Prishtinës ishin 35 pjesëmarrës. Prej tyre 8 gjyqtarë, 9 prokuror si dhe 17 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor dhe 1 praktikantë.



Praktika Gjyqësore ndërmjet Prokurorëve dhe Gjyqtarëve

Më 10 korrik 2023, në bashkëpunim me US-DOJ/OPDATnë kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi për përmirësimin e Praktikës Gjyqësore ndërmjet Prokurorëve dhe Gjyqtarëve.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte përmirësimi dhe unifikimi i Praktikës Gjyqësore ndërmjet Prokurorëve dhe Gjyqtarëve për zgjidhjen e drejtë të rasteve të veprave penale të korrupsionit, në veçanti të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar.

Në pjesën e parë trajnimi u fokusua në cilësinë e hetimit dhe standardin dhe problematikat lidhur me interpretimin e dashjes për veprat penale korruptive, kur qëllimi i personit zyrtar është përfitimi i dobisë, shkaktimi i dëmit, apo shkelja e të drejtave të personit tjetër. Vëmendje e veçantë i është kushtuar dashjes direkte përballë asaj indirekte, me ç'rast u trajtuan provat rrethore dhe fakti se ato mund të përdoren për të vërtetuar dashjen kriminale në rastet penale që lidhen me korrupsionin. Më tej u diskutua për definicionin e personit zyrtar, Kualifikimin juridik të veprave penale meqë është vlerësuar se ka raste që nuk bëhet

konform përshkrimit faktit. Në vijim për Pranimin/mospranimi e fajësisë në bashkëkryerje/dëshmitarët bashkëpunues/marrëveshja mbi pranimin e fajësisë, problematikat lidhur me zbatimin e Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë (LKZKP).

Në pjesë e dytë trajnimi u përqendrua në ngritjen e nivelit të bashkëpunimit ndërmjet prokurorëve dhe gjyqtarëve për evitimin dhe reduktimin në masë të rasteve të shtyrjes së seancave dhe parashtrimin të kërkesave në fund të orarit të punës. Vëmendje e veçantë iu kushtua përgatitjes së listës së kujdestarisë dhe këmbimin e saj ndërmjet prokurorisë dhe gjykatës në baza mujore.

Metodologjia e zbatuar është e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 11 gjyqtarë dhe 15 prokuror dhe prokuror nga niveli themelor.



Program i Specializuar i Trajnimit-Ekstremizmi, radikalizmi dhe terrorizmi-Sesioni II

Më 11-12 Korrik 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Program i Specializuar i Trajnimit Ekstremizmi, radikalizmi dhe terrorizmi – Sesioni II”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe profesionistëve tjerë lidhur me Kornizen strategjike dhe institucionale të bashkëpunimit në çështjet kundër terrorizmit për zgjidhjen e drejtë dhe vendosjen meritorë të rasteve përkatëse.

Në ditën e parë trajnimi u përqendrua në shpjegime të hollësishme sa i përket teknikave të hetimit dhe të provuarit e veprave penale të terrorizimit që janë thelbësore në luftën kundër kësaj dukurie. Vëmendje e veçantë i është kushtuar bashkëpunimit ndërkombëtar dhe mbështetjes së autoriteteve lokale për të zbuluar dhe ndaluar individët dhe grupet ekstremiste. Përveç kësaj u vunë në pah edhe liritë dhe të drejtat e njeriut të rrezikuara nga veprimet terroriste, viktimat e terrorizmit, qasja në drejtësi nga perspektiva e viktimave si dhe sanksionet penale kundër kryesve të veprave penale të terrorizmit.

Në ditën e dytë përveç elaborimit të kornizës ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare ndaj terrorizimit, u analizuan raste të vërteta dhe raste praktike si ilustrim për metodat e përdorura për parandalimin e rekrutimit, shkatërrimin e propagandës ekstremiste dhe rehabilitimin e individëve të radikalizuar.

Rëndësi e veçantë iu kushtua edhe Strategjisë kombëtare kundër terrorizmit në Kosovë dhe obligimi i institucioneve ligj zbatuese në zbatim të kësaj strategjie dhe njëherësh në parandalimin dhe luftimin e terrorizimit. Po ashtu u ofruan edhe sqarime sa i përket ndërlidhjes ndërmjet krimit të organizuar dhe terrorizmit.

Metodologjia e trajnimit është e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar edhe raste praktike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 2 gjyqtarë, 5 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor nga prokuroritë si dhe 5 zyrtarë policor, 3 zyrtarë nga Dogana e Kosovës si dhe 2 zyrtarë nga Njësia e Inteligjencës Financiare.



Praktika gjyqësore në çështje nga procedura jokontestimore

Më 12-13 Korrik 2023, në mbështetje të GIZ, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar “Trajnimi për praktikën gjyqësore në çështje nga Procedura Jokontestimore”.

Qëllimi i kësaj tryeze ishte identifikimi i praktikave të gabuara dhe ofrimi i zgjidhjeve adekuate për procedurën jokontestimore në përgjithësi dhe procedurat e veçanta.

Për dy ditë me radhë në tryezë janë trajtuar çështjet thelbësore të procedurës së jokontestimore, përkatësisht fillimi i procedurës jokontestimore, pjesëmarrësit në procedurë, rastet kur lënda duhet gjykuar në procedurën kontestimore, prishja ose ndryshimi nga gjykata që ka dhënë vendimin në shkallë të parë, mjetet juridike, rregullimi i gjendjeve personale dhe familjare, rregullimi i marrëdhënieve pasurore dhe rregullimi i çështjeve tjera jokontestimore.

Për të gjitha situatat e lartpërmendura janë nxitë diskutime dhe angazhime të pjesëmarrësve si rezultat i të cilave janë diskutuar deri në detaje problemet ligjore, sfidat në praktikë, praktikat e gabuara duke u ofruar pjesëmarrësve zgjidhje adekuate e të cilat zgjidhje janë edhe në pajtim me standardet ndërkombëtare.

Metodologjia e trajnimit ishte diskutim interaktiv, prezantim i çështjeve përmes rasteve, diskutim për rastet dhe përmbledhje e konkluzave për çështjen e diskutuar.

Përfitues të kësaj tryeze ishin: 31 gjyqtarë, 4 avokatë shtetëror si dhe 15 zyrtarë të ndihmës juridike falas.



Trajnim: Bashkëpunimi Juridik ndërkombëtar në çështje civile

Më 28-29 korrik 2023, në mbështetje të EKOJUST, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë: Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në fushën civile.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje civile veçanërisht pas hyrjes në fuqi të dy marrëveshjeve dypalëshe dhe ligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet civile.

Për dy ditë me radhë janë diskutuar aspekte të rëndësishme të procedimit të kërkesave për ndihmë juridike në çështjet civile me shtetet veq e veq me të cilat Kosova ka raste më shumë si dhe me shtetet që ka marrëveshje dy palëshe në fuqi dhe që rrjedhin prej procesit të përfunduar të suksedimit.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit patën rastin e studimit të dy raste praktike dhe të ndarë në dy grupe ofruan perpspektivën e tyre për rastet përkatëse.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe legjislacionit më të ri në BE, sa i përket bashkëpunimit juridik ndërkombëtar duke përfshirë edhe legjislacionin sekondar me ç'rast u potencua që Rregullorja (EC) nr. 1393/2007 është zëvendësuar me rregulloren (EU), 2020/1784, që nga 1 korriku 2022. Po ashtu, Rregullorja (EU) 2020/1783 është zëvendësuar me rregulloren (EC) No 1206/2001, po ashtu nga 1 korriku 2022. Gjithashtu, pjesëmarrësit janë njoftuar me “The European Union acquis vs conventions of the Hague Conference on Private International Law”.

Krejt në fund pjesëmarrësit janë njoftuar nga dy trajnerët ndërkombëtar edhe me e-CODEX. Metodologjia e trajnimit ishte diskutim interaktiv, prezantim i çështjeve përmes rasteve, diskutim për rastet dhe praktikën e mira dhe shembujt e shteteve anëtare të BE-së.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 2 gjyqtarë dhe 8 zyrtarë ligjor nga Departamenti i bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në Ministrinë e Drejtësisë.

Trajnim: Vlerësimi i rrezikshmërisë në rastet e dhunës në familje

Më 31 gusht 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme në bashkëpunim me OPDAT është realizuar trajnimi i radhës me temë “Vlerësimi i Rrezikshmërisë në Rastet e Dhunës në Familje”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të mbrojtësve të viktimave dhe zyrtarëve policor lidhur me procedurat dhe mjetet për vlerësimin e rrezikut në rastet e dhunës në familje në mënyrë që kryesit e dhunës të mbahen përgjegjës dhe viktimat të gëzojnë mbrojtjen e duhur nga institucionet përkatëse.

Trajnimi në fillim u fokusua në shpjegimet e hollësishme sa i përket kushteve të caktimit të paraburgimit, trajtimit të viktimave, komunikimit ndër institucional, mbrojtjes së

viktimave, për faktorët lehtësues dhe rëndues si dhe për indikatorët e rrezikut në rastet e dhunës në familje. Vëmendje e veçantë iu kushtua vështirësive dhe sfidave të praktikës gjyqësore të cilat u diskutuan nga ana e mbrojtësve të viktimave dhe zyrtarëve policor përmes të cilave ofruan zgjidhjet më të mira ligjore.

Në trajnim vend të konsiderueshëm iu kushtua edhe perspektivës së SHBA-ve përmes ofrimit të shembujve nga praktika.

Metodologjia e zbatuar është e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: 2 prokurorë 5 Zyrtar nga Qendra për punë sociale si dhe 4 zyrtarë policor.

Aktivitetet trajnuese për bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor të gjykatave dhe prokurorive

Trajnim: Roli i prokurorit, detyrimet publike dhe përgjegjësitë-praktikat në Britaninë e Madhe

Më 03-04 korrik 2023, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Chemonics organizuan trajnimin për bashkëpunëtorë profesional me temë “Roli i prokurorit, detyrimet publike dhe përgjegjësitë - praktikat në Britaninë e Madhe”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me hetimet, mbledhjen e provave si dhe përpilimin e aktakuzës.

Gjatë këtij trajnimi u diskutua për fazat e hetimit, rolin dhe detyrat e prokurorit, detyrat dhe përgjegjësisë në gjykatë. Në mënyrë të hollësishme u elaboruan parimet kryesore lidhur me draftimin e aktakuzës, duke theksuar që aktet akuzuese nga Prokuroria Speciale të kenë rrjedhë të mirë dhe të shqyrtohen nga Departamenti Special i Gjykatës Themelore, duhet të jenë të përpiluara mirë, të përmbajnë arsyetimin e mirë dhe të argumentuara me

prova.

Me theks të veçantë u diskutua trajtimi i dëshmitarëve, marrja në pyetje e tërthortë e të pandehurve dhe dëshmitarëve të mbrojtjes si dhe fjala përfundimtare.

Pjesëmarrësit gjatë këtij trajnimi patën mundësinë e vëzhgimit të seancës gjyqësore virtuale në Mbretërinë e Bashkuar.

Metodologjia e zbatuar është e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: 8 Bashkëpunëtor profesional nga Prokuroria Speciale e Kosovës si dhe 6 bashkëpunëtor profesional nga departamenti special në Gjykatën Themelore në Prishtinë.



Trajnim: Moduli bazik-aspekti penal procedural-Grupi II

Më 18 korrik 2023, në bashkëpunim me SAEK, për Grupin e III-të të bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave dhe prokurorive që kanë përfunduar sesionet nga moduli bazik aspekti material penal është vazhduar me sesionin e radhës për aspektin procedural penal me theks te “Fazat e procedurës penale”

Qëllimi i këtij trajnimi ishte përmirësimi i njohurive sa i përket fazave të procedurës penale me specifikat e veçanta për secilën fazë për zbatimin e drejtë të procedurës penale.

Trajnimi u përqendrua në shpjegimet e nevojshme sa i përket fazës së hetimeve e cila fillon me ngritjen e aktvendimit për fillimin e





hetimeve, fazën e ngritjes së aktakuzës dhe deklarimit që bije nën kompetencën e prokurorit, fazën e shqyrtimit nga gjykata si dhe për fazën e mjeteve juridike.

Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit patën rastin që përmes rasteve nga praktika gjyqësore, përmes punës në grupe të hartojnë vendimet gjyqësore, të diskutojnë dhe të japin opinione ligjore dhe njëkohësisht të zbërthejnë dispozitat ligjore.

Përfitues në trajnimin ishin 17 pjesëmarrës prej tyre 10 bashkëpunëtorë profesional dhe 7 zyrtar ligjor .




Vijueshmëria në trajnime në PTF e shfaqur përmes grafikoneve






Vijueshmëria në trajnime në PTV e shfaqur përmes grafikoneve



Numri i pjesëmarrjes në trajnime në bazë të Instutucioneve - Korrik 2023



Vijueshmëria në trajnime në PTV përmes grafikoneve



Vijueshmëria në trajnime në PTV përmes grafikoneve



Akademia e Drejtësisë

<https://ad.rks-gov.net>

infoad@rks-gov.net

Rr. "Murat Mehmeti" nr. 1-3, Prishtinë

Tel:+383 38 200 18 660